

Ligj
për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhim me pronë të konfiskuar,
dobi pronësore dhe sende të konfiskuara në procedurë penale dhe
kundërvajtëse

Neni 1

Në Ligjin për menaxhim me pronë të konfiskuar, dobi pronësore dhe lëndë të konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtëse ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/2008, 145/10, 104/13 dhe 187/13), në nenin 16 pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Për emërimin e Drejtorit të Agjencisë për Menaxhim me Pronë të Konfiskuar publikohet shpallje publike së paku në tre gazeta ditore, të cilat botohen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, prej të cilave njëra nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% të qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase."

Neni 2

Neni 17 ndryshohet si vijon:

Si drejtor i Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të kryer VII/1;
- 4) të ketë minimum pesë vjet përvojë pune nga sfera e drejtësisë ose ekonomisë,
- 5) të posedojë një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT-së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë,
 - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) të ketë dhënë testin psikologjik ose testin e integritetit."

Neni 3

Drejtori i Agjencisë i zgjedhur deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur.

Neni 4

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji që kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.